

Roli i sistemit te kreditimit ne nje ekonomi te hapur

Dhimiter TOCI

Konkurenca e dukshme e ekonomise per shkak te zhvillimeve globalizuese, ka vene ne perballje sektorin privat per rritjen e kokurueshmerise net e gjithë treguesit, per ti bere balle konkurences se hapur ne treg.

Sektori bankar gjithnje ka luajtur rol te rendesishem ne kreditimin e ekonomise. Edhe tani kur shqiperia ka nenshkruar marreveshjen me OBT behet me i domosdoshem. Rritja e shkalles se kreditimit nga sektori bankar per sketoret privat eshte nje rrugesgjidhje pozitive ne mbeshtetje te rritjes dhe zgjerimit te aktiviteve te bizneseve qe do te japin ndikimin e tyre pozitiv ne rritjen e konomike sdhe ne rritjen e shkalles se punesimit.

Kreditimi i ekonomise ne vitet e fundit ka njohur rritje. Ne vitin 2005, por sidomos gjate vitit 2006 ka njohur rritje teper te dukshme. Keshtu, nga 674 milione dollare qe ishte kreditimi i sektorit bankar per sektorin privat ne vitin 2004, ai arriti ne 1,2 miliarde USD ne vitin 2005 ose 14,6 % te GDP – se dhe 1,8 miliarde dollare ne fund te vitit 2006 ose 20 % te GDP – se, e cila konsiderohet dhe nje tregues shume i mire i kreditimit per vendin tone.

Me poshte ne tabelen permbledhese po paraqesim te dhenat per kreditimin ne % te GDP

Kreditimi ne vlere i sektorit Privat ne milione USD \$ e ne % te GDP- se		
vitet	Kredia USD \$ ne milione	Ne % te GDP - se
1994	74	3,8
1995	88	3,7
1996	103	3,9
1997	88	3,9
1998	97	3,2
1999	76	2,1
2000	117	2,9
2001	180	3,8
2002	223	4,7

2003	414	6,8
2004	674	8,8
2005	1210	14,6
2006	1795	20,1

Rritmet e rritjes se kreditimit te sektorit privat nga sektori bankar kane qene te kenaqshme vitete e fundit, por ka akoma rezerva te mundshme dhe nevoja te medha per kreditim te sektorit privat.

Ne rritjen e zhvillimn e ekonomise rol kane dhe nxitja e investimeve te huaja direkte. Politikat e nxitjes se investimeve te huaja direkte per vendin tone jep impaktin e vet ne ekonomi e puinesim . Ivestimet e huaja kane njohur nje stop per shkak te situatave tranzitore qe ka kaluar vendi yne. Ky proces ka qene teper i ulet per shume vite radhazi qe nga viti 1991. Keshtu vendi yne u fut ne vitin e pare pas hapjes se ekonomise me 8 milione USD \$ investime te huaja direkte dhe pas 13 vitesh, 1991 – 2003 arriti 1,1 miliarde USD \$ ose 350 USD \$ per fryme te popullsisë. Ky tregues eshte shume I ulet pot e krahasohet me vende te tjera si s Rumania,Bullgaria, etj , ndersa keto tre vitet e fundit investimet e huaja direkte kane arritur ne rreth 900 milione USD \$ dhe te gjitha se bashku per 16 vitet e trazicionit rreth 2 miliarde USD \$ ose mbi 600 USD \$ per fryme te popullsisë.

Investime e huaja direkte ne vendin tone ne USD \$ dhe USD \$ per fryme		
vitet	Investime Hujaja Direkte USD \$ milione	USD \$ per fryme te popullsisë
1991	8	2
1992	32	10
1993	45	14
1994	53	17
1995	70	22
1996	90	27
1997	47,5	14
1998	45	14
1999	41,2	12
2000	143	42
2001	207	67
2002	135	44
2003	178	57
2004	332	106

2005	265	84
2006	293	92

Rritja e ritmit të Investimeve të Huaja Direkte për frymë sidonmoas në vitet e fundit, flet për një tendencë pozitive në lidhje me shkallën e investimeve dhe të ritmeve të rritjes ekonomike në vendin tonë.

Qeveria dhe institucionet qendrore duhet të inkurajojnë dhe të nxisin në formë të ndryshme rritjen e shkallës së investimeve të huaja direkte në vendin tonë. Zhvillimi i vendit nuk mund të bëhet vetëm nëpërmjet investimeve të brendshme. Proceset e globalizimit nxisin për të rritur shkallën e investimit të kapitalit në vendin tonë, kështu ekonomia jonë do të bëhet konkurruese si pjesë e tregjeve rajonale e më gjere.

Por, të përfitosh investime duhet të kuptuar që ato vijnë në një terren të favorshëm. Duhet të rregullohet situata përsa i përket kushteve të lehtësive për të thithur investime të huaja. Askush nuk investon, nëse i rriten kostot në mënyrë të vendit të tyre të origjinës, ose e thënë ndryshe ato do të shkojnë të investojnë edhe në vende të tjerë vetëm për të ulur kostot investuese. Kjo duhet të mbahet mirë parasysh. Institucionet qendrore të japin përparësi investimeve të mëdha të eliminojnë burokracitë e fenomeneve të demshme të ndryshme që investimet të vijnë. Kështu do të zgjidhen edhe problemet e papunesisë që për vendin tonë shifrat janë të larta.

FSTBSH, si edhe deri tani, ka patur një rol ndërmjetësues në kreditimin e sektorit privat nga bankat. Në do të nxisim që ky proces të shkojë mirë, sepse kështu rrisim edhe shkallën e pjesëmarrjes në punë të njerezve.

Faleminderit !